



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATË/A	07.06.2018
REFERENC-Ë :	
PËR/ZA/TO:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunes së Lipjanit
CC:	Fauz Xheaili - Nënkyetar i Komunës së Lipjanit
	Lulzim Qerimi - Nënkyetar i Komunës së Lipjanit
NGA/OD/FROM:	Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raport Mujor 01.05.2018 - 31.05.2018

Trendi i inkasimit të të hyrave nga qeraja kanë vazhduar të jetë në rritje edhe në muajin Maj. Përqindja e inkasimit të të hyrave nga qeraja është më e madhe për 161 % në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 2017.

Të hyrat nga qeraja pritet të rriten ende edhe në muajt në vijim ngase është rritur bashkepunimi në mes të Zyrës Pronësore Juridike, Zyrës Ligjore, Avokatit të Komunës, Asamblesë Komunale dhe Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim gjegjësisht zyrës për menaxhimin e të hyrave nga qeraja. Nga lista e lokaleve të lira, për shumicën e lokaleve është marrë ose është propozuar në Asamblesë Komunale të merret vendimi për dhënje në shfrytëzim afatshkurtër me qëllim të rritjes së të hyrave komunale.

Si rrejdhojë, bazuar në vendimin paraprak për dhënjen në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës së Lipjanit, respektivisht dhënjen e katër lokaleve afariste për subjektet e interesuara politike, të aprovuar nga Asambleja Komunale më 30.04.2018 dhe mbas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Komisioni për Vlerësimin e Pronave do të bëjë shpalljen e katër lokaleve për të cilat është marrë vendim. Poashtu, me propozimin e pranuar nga zyra pronësore juridike do të procedohen për shpallje edhe pesë lokale tjera për të cilat është marrë vendimi në kuvend për dhënje në shfrytëzim afatshkurtër.

Organizata Help në kuadër të projektit “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor 2017-2018” nga 91 aplikuesit e vizituar në terren ka përzgjedhur 43 përfitues dhe 7 janë në listën rezervë. Nënshkrimi i kontratave në mes të organizatës HELP dhe klientëve përfitues është bërë në Sallën e Kuvendit Komunal më 10.05.2018 në ora 10:00. Bazuar në informacionet e marra

nga Organizata HELP, projekti është në fazën e tenderimit për blerjen e mjeteve të punës për përfituesit në këtë thirrje.

Më 18.05.2018, Komuna e Lipjanit, në kuadër të fazës së parë të projektit “Përmirësimi i Klimës së Investimeve II përmes thjeshtimit të procedurave administrative” ka dorëzuar në IFC/Bankë Botërore listat e procedurave për të gjitha drejtoratet që lëshojnë leje, licenca dhe pëlqime e të cilat ndikojnë në lehtësimin e të bërit biznes. Në muajin qershor do të vazhdohet me aktivitetet tjera të cilat përfshijnë plotësimin e formularëve për secilën procedurë dhe dorëzimin në IFC/Bankën Botërore.

Mbas hyrjes në fuqi të Vendimit për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik 2018-2023, i cili vendim është aprovuar nga Asambleja Komunale, pranimit të interpretimit ligjor dhe publikimit në webfaqen e Komunes së Lipjanit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim ka dorëzuar propozimin për formimin e grupit punues.

Bazuar në Qarkoren e Bëndshme Buxhetore të pranuar nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa është dorëzuar Planifikimi Buxhetor për 3 vitet e ardhshme për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021. Në këtë propozim planifikim janë përfshirë të gjitha shpenzimet në të gjitha kategoritë ekonomike si dhe investimet kapitale të nevojshme për zhvillim ekonomik lokal.

Si pjesë e informimit të rregullt mujor, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim ka informuar Sekorin Pronëso- Juridik për pagesën e qerave, bazuar në kontratat e lidhura për lokalet dhe pronat tjera komunale.

Komuna e Lipjanit është zgjedhur Komuna e parë në nivel vendi nga USAID në Indeksin e Konkurrueshmërisë së Komunave për vitin 2018. Fokus i studimit të Indeksit të Konkurrueshmërisë është matja e mjedisit të favorshëm të të bërit biznes. Për Komunen e Lipjanit kjo ngritje në vitin 2018 është shumë e rëndësishme e sidomos në kohën kur Kosova, sipas Bankës Botërore, ka bërë një përmirësim të jashtëzakonshëm duke u renditur në vendin e 40-të krahasuar me vendin e 86-të sa ishte më parë.